



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:255278
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05766702

KPPP.nr. 1250/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbartimore të kreditorit NTP KGT me seli në Prishtinë, me NRB 70004006, të cilin me autorizim e përfaqëson Florian Petani avokat n; Prishtinë, kundër debitorit Ministria e Punëve dhe Mirëqenies Sociale të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.192/17 të datës 31.07.2017, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, me seli të zyrës në Prishtinë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike me datë 27.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit "Ministria e Punëve dhe Mirëqenies Sociale", ashtu që MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.192/17 I datës 31.07.2017 i Përmbartuesit Privat Emine Sherifi Lubeniqi, për pjesën e detyrimit në shumën prej 35,385.05 euro € (tridhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë euro e pesë cent).

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.192/17 të datës 31.07.2017, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturë me nr.02/16 e datës 05.02.2016, faturë nr.17/16 e datës 31.03.2016, faturë nr.19/16 e datës 22.04.2016, faturë me nr.23/16 e datës 17.05.2016, faturë nr.41/16 e datës 20.12.2016, fatura me nr.45/16 e datës 30.12.2016, faturë nr.01/17 e datës 04.01.2017, faturë

nr.02/17 e datës 26.01.2017, faturë 05A/17 e datës 27.02.2017, faturë me nr. 05/17 e datës 27.02.2017, faturë e datës 06/17 e datës 03.03.2017, faturë nr.07/17 e datës 03.03.2017, faturë nr.09/17 e datës 24.03.2017, faturë nr.10/17 e datës 24.03.2017, faturë nr.11/17 e datës 24.03.2017, faturë nr.12/17 e datës 30.03.2017, faturë nr. 16/17 e datës 11.04.2017, faturë nr. 17/17 e datës 11.04.2017, faturë nr.18/17 e datës 11.04.2017, faturë nr.19/17 e datës 11.04.2017 dhe faturë nr.20/17 e datës 11.04.2017, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit t'ia paguaj kreditorit shumën prej 50,710.24 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% si dhe të gjitha shpenzimet dhe efikasitetin e përmbartimit aq sa do të bëhen sipas listës së shpenzimeve.

Debitori, përmes avokaturës shtetërore, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbartimor me të cilin ka theksuar se i njëjti është marr me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore. Më tej ka shtuar se debitori faturën 18/17 të datës 11.04.2017, asnjëherë nuk e ka pranuar pasi që e njëjta nuk është dërguara, ndërsa tek fatura me nr.45/16 e datës 30.12.2016 janë vërejtur gabime në përlllogaritjen e çmimeve. Ndërsa lidhur me faturat tjera ka theksuar se pagesat që rrjedhin nga ato do të paguhen në të ardhmen pas përmirësimeve në faturat përkatës. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit dhe të anulohet urdhri për përmbartim.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se debitori nuk ka ofruar asnjë provë me prapësimin e paraqitur, e po ashtu të gjitha faturat e kreditorit janë pranuar nga debitori, si dhe nuk ka asnjë gabim në fatura ku të gjitha çmimet janë të përcaktuar konform kontratës numër 209/14/001/221. Më tej ka theksuar se faturat me nr.7/17, 9/17,10/17 dhe 11/17, debitori i ka paguar pas pranimit të propozimit për përmbartim, ndërkaq afati i pagesës ka qenë 30 ditë e që pas afatit do të rrjedh kamatë vonesa për të njëjtat. Me propozim për gjykatën që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr.1176/19 të datës 21.11.2018, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit për shumën prej 35,385.05 euro, ndërsa ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhri përmbartimor P.nr.192/2017 të datës 31.07.2017 në shumë prej 15,324.74 euro për shkak të përmbushjes së obligimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin Ac.nr.1698/2020 të datës 18.10.2021 ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore

në Prishtinë në pikën I të diapozitivit dhe për këtë pjesë çështja i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa pika II e dispozitivit mbetet e pashqyrtuar.

Në ri procedurë, lënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë PPP.nr.1176/17, ka marr numrin PPP.nr.1371/2021, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, e njëjta është transferuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për në Gjykatën Komerciale të Kosovës për shqyrtim të mëtejme në bazë të kompetencës lëndore, dhe ka marrë numrin KPPP.nr.1250/22.

Gjykata, konform rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, e me qëllim të vlerësimit të validitetit të prapësimit, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën dëgjimore, në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i autorizuar i debitorit i propozoi gjykatës që procedurën ta vazhdoj sipas rekomandimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit, ashtu që ti pranoj pagesat për faturat 05/17,05A/17, 16/17, 17/17, 19/17 dhe 20/17, ndërsa për faturat të cilat asnjëherë nuk janë dorëzuar dhe atë faturat 41/16, 23/16, 19/16, 18/17, 45/16 ka propozuar që për këtë pjesë të shfuqizohet urdhri përmbarimor.

Përfaqësuesi i kreditorit gjatë seancës dëgjimore publike ka theksuar se ne tërësi e kundërshtojnë pohimet dhe pretendimet e debitorit duke shtuar se debitori gjykatës nuk I ka sjelle asnjë provë materiale mbi te cilën do të mbështesë thëniet e veta. Më tej ka shtuar se objekt i procedurës përmbarimore janë faturat 02/16, 17/16, 19/16, 23/16, 41/16, 45/16, 01/17. 02/17. 05/17, 05A/17, 06/17, 07/17, 16/17,17/17,18/17 ne fund të faturës në shumë totale 35.633.80 cent ne lidhje me pretendimet e debitorit për faturën 45/16 ka pretenduar se me asnjë provë të vetme nuk ka provuar se fatura është kthyer ne korrigjim si pasojë e gabimeve materiale, mandej fatura e njëjtë rezulton e pranuar dhe e vulosur nga kjo e fundit dhe e konstatuar nga komisioni pranues që është në përputhje me kërkesat dhe kushtet kontraktuale. Në lidhje me thëniet e debitorit mbi kinse mospranimin e faturave 19/16,23/16,41/16,18/17 ka shtuar se në shkresat e lëndës me të cilat gjykata disponon gjenden dërgesat e materialit të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me faturat në fjalë pra për secilën faturë fletë të theksuar më lartë ekziston një fletë dërgese specifike e veçantë e cila është nënshkruar nga debitori dhe kreditori si pranues i mallit dhe shërbimit në faturë, flete dërgesa mban të njëjtin numër të faturës dhe së bashku me mallin dhe materialet gjendet edhe fatura në lidhje me pretendimet e

debitorit mbi mos përmbushjen e detyrimeve që dalin nga faturat 05/17,05A/17,16/17,17/17,19/17,20/17. Ka shtuar se faturat 19/17 dhe 20/17 janë paguar nga debitori dhe nuk janë objekt i procedurës përbarimore meqenëse pretendime e debitorit janë se këto fatura janë paguar ne nuk kemi pranuar asnjë provë materiale asnjë dëftesë transaksion që dëshmon se janë paguar përveç faturës 19/17 dhe 20/17. Në pyetjen e Gjykatës lidhur me sqarimin e vlerës së kërkuar dhe faturave si në propozim, përfaqësuesi deklaroi se vetëm faturat e lartcekura mbesin objekt i përbarimit, ndërsa të tjerat të cilat nuk janë cekur tashmë janë paguar. Në seancë gjykata po ashtu ka marr aktvendim me të cilin ka obliguar palët që pas pranimit të dëshmive në shkresa të lëndës të dorëzuara nga kreditori, të deklarohen lidhur me të njëjtat në afatin shtatë ditor. Megjithatë, palët nuk ishin deklaruar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP), si dhe duke marrë për bazë vërejtjet sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.4915/19 të datës 23.02.2021, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi sikurse në diapozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se kreditori dhe debitori kanë lidhur kontratë publike “Shtypje dizajnim, filmim dhe përkthimi i materialeve të MPM-së”, me numër identifikues 209/14/001/221 dhe se faturat lëndore burojnë nga kontrata e lartcekur dhe se urdhri përbarimor është lejuar për arkëtimin e borxhit nga faturat në shumë prej 50,710.24 Euro.

Rrjedhimisht, Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se faturat lëndore mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se të njëjta janë pranuar nga debitori, mirëpo të njëjtat nuk janë përmbushur.

Gjykata vendosi si dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.192/17 të datës 31.07.2017 për shumën në vlerë prej 35,385.05 euro, kjo për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat sa i përket pjesës së borxhit, bazohet në dokumentet e besueshme respektivisht faturat e lartcekur të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Me rastin e vendosjes, Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se faturat objekt i këtij përmbartimi nuk janë të pranuar asnjëherë nga debitori, por këtë pretendim e vlerësoj si të paqëndrueshëm kjo për faktin se secilës faturë i është bashkëngjitur dëshmia mbi pranimin e mallit e lëshuar me rastin e dorëzimit të faturës dhe mallit nga kreditori, dhe secila dëshmi mbi pranimin e mallit përmban nënshkrimin e debitorit, përmban përshkrimin dhe sasinë e njëjtë të produkteve sikurse në faturat

objekt i këtij përbarimi, dhe secila nga to, është lëshuar në datën e lëshimit të faturës nga kreditori dhe liferimit të mallit tek debitori.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit se fatura 45/16 i është kthyer për korrigjim kreditorit, por që një pretendim ishte i pambështetur në prova, ku edhe vetë e paditura në prapësim ka parashtruar se gojarisht është kërkuar një korrigjim i tillë.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1250/22, datë 30.05.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.